



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 23.1.2024

- Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 606, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Mariola Mërtiri
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese

*Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,*

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së të datës 16.2.2023, Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit, si dhe parashtrimeve me shkrim të depozituara në seancën gjyqësore të datës 16.1.2024, zhvilluar në kuadër të këtij gjykimi, konstaton se pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e shkaqeve të ankimit.

Për sa u takon shkaqeve të ankimit, referuar edhe parashtrimeve me shkrim gjatë këtij gjykimi, lidhur me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale, pasi vlerësoi aktet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pas riçeljes së hetimit gjyqësor nga ana e Kolegjit, për secilin shkak ankimi, Komisioneri Publik vlerëson se:

### **I. Kontrolli i pasurisë**

**1.** Komisioni, nga hetimi administrativ për vlerësimin e kontrollit të pasurisë, bazuar në përcaktimet e nenit D të aneksit të Kushtetutës, ka konkluduar se: [...] *Subjekti ka bërë deklaram të saktë të pasurive të saj dhe personave të lidhur me të dhe se ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurive të saj ... Çmon se subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...].<sup>1</sup>*

**2.** *Lidhur me shkakun ankimor mbi pasurinë apartament me sip. 83,88 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Fier, në vlerën 4.500.000 lekë, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i*

<sup>1</sup> Referohuni f. 69 të vendimit të Komisionit.

rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, në seancën e datës 16.1.2024, nuk paraqiti ndonjë provë të re, lidhur me vërtetësinë e deklarimeve dhe burimet e ligjshme të personave të tjerë të lidhur, shtetasve \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\*, \*\*\*, për të dhuruar shumat e deklaruara.

2.1 Sikundër trajtuar gjerësisht në shkaqet e ankimit, *për sa i përket burimit të këstit të parë në vlerën 2.260.000 lekë*, Komisioneri Publik, në vëmendje të përmbajtjes së aktit - Rekomandim dhe *Gjetjeve* të ONM-së, vlerëson se, edhe pas shpjegimeve të dhëna në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi burimet e ligjshme të personave të tjerë të lidhur si dhurues, shtetasve \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\*, \*\*\*, si më poshtë trajtuar:

2.1.1 *Për sa i përket ligjshmërisë së burimit të shumës së deklaruar të dhuruar nga shtetasi \*\*\*, \*\*\*, në vitin 2011*, Komisioneri Publik rithekson se e gjen jo bindës arsyetimin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit duhet të justifikojë burimin e ligjshëm brenda kufijve të shumës objekt dhurimi. Nga aktet e administruara kanë rezultuar fakte se personi tjetër i lidhur ka investuar shuma të konsiderueshme në shoqërinë “\*\*\*\*” sh. a., (ku 60% e aksioneve të kapitalit i përkasin dhuruesit \*\*\*, \*\*\*), dhe pikërisht nga ky aktivitet janë gjeneruar të ardhurat e deklaruara si një nga burimet e krijimit të shumës së dhuruar. Nisur nga ky fakt, vlerësohet se nuk do të ishte një analizë objektive dhe tërësore, nëse ky fakt do të përjashtohet *a priori*, bazuar në një interpretim formal dhe të ngushtë të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016 dhe, në analizën financiare të burimeve të ligjshme të dhuruesit \*\*\*, \*\*\*, duhen përfshirë edhe shpenzimet/investimet, të cilat kanë shërbyer për krijimin e biznesit nga i cili janë gjeneruar të ardhurat për dhurimin e shumës 1.000.000 lekë. Sa më sipër, vlerësohet nisur nga fakti se këto shpenzime paraqesin lidhje organike dhe logjike, të cilat nuk mund të mëvetësohen/parcelizohen për efekt të procesit të rivlerësimit, duke marrë në konsideratë në këtë mënyrë si të ardhurat e *krijuara/përfituara nga kjo shoqëri, ashtu dhe investimi për të*.

2.1.1.1 Në të njëjtën logjikë, në analizën financiare të personit tjetër të lidhur/dhuruesit, duhet të përfshihet edhe investimi i tij në shoqërinë “\*\*\*\*. \*\*\*\*. \*\*\*\*.” sh.p.k., themeluar në \*\*/5.2004, në të cilën shtetasi \*\*\*, \*\*\*, (dhuruesi) zotëron 40% të kapitalit themeltar të shoqërisë, pasi ka investuar vlerën prej 4.000.000 lekë dhe subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjatë hetimit administrativ, si një nga burimet e krijimit të shumës së deklaruar të dhuruar nga z. \*\*\*, \*\*\*, edhe të ardhurat nga punësimi i tij pranë shoqërisë “\*\*\*\*.\*\*\*\*.\*\*\*\*.” sh.p.k.

2.1.1.2 Pamjaftueshmëri financiare e burimeve të ligjshme të dhuruesit \*\*\*, \*\*\*, për t’i dhuruar shumën 1.000.000 lekë subjektit dhe bashkëshortit të saj në vitin 2011, do të rezultonte edhe në vlerësim të pretendimeve të subjektit, mbi përfitimin e të ardhurave nga shitja e kuotave të shoqërisë “\*\*\*\*.\*\*\*\*.\*\*\*\*.” sh.p.k., nga ana e shtetasit, z. \*\*\*, \*\*\*,<sup>2</sup> dhe të ardhurave të përfituara nga z. \*\*\*, \*\*\*, nga likuidimi i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a.<sup>3</sup>, edhe pse nuk provohen transaksionet monetare.

2.1.2 Komisioneri Publik, edhe për sa i përket mundësisë financiare dhe ligjshmërisë së burimit të shumës së deklaruar të *dhuruar prej 1.260.000 lekë, nga personi tjetër i lidhur, z. \*\*\*, \*\*\*,* rithekson se, në analizën e kryer, në mesin e të ardhurave të dhuruesit, z. \*\*\*, \*\*\*, nuk duhet të përfshihen të ardhurat nga qiraja e një mjeti (autobus) për periudhën 2005 - tetor 2007, si dhe të ardhurat nga shitja e tij në vitin 2007, pasi si burim krijimi për këtë pasuri, janë

<sup>2</sup> Shitur në datën \*\*/9.2004, në vlerën prej 400.000 lekë.

<sup>3</sup> Bazuar në raportin e likuidatorit të shoqërisë, në shumën rreth 2.6 milionë lekë.

deklaruar të ardhurat nga punësimi informal në emigracion i shtetasit \*\*\*. \*\*\*, të ardhura të cilat Komisioni nuk i ka përfshirë në analizën financiare.

2.1.2.1 Gjithashtu, nga hetimi administrativ ka rezultuar se të ardhurat e dhuruesit, z. \*\*\*. \*\*\*, kanë shërbyer edhe për investimin e një shume prej 4.000.000 lekë të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në kapitalin e shoqërisë “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k.<sup>4</sup> Gjatë hetimit, subjekti vetë ka kërkuar përfshirjen në analizën financiare të dhuruesit, të të gjitha të ardhurave të tij që nga viti 1990, përfshirë dhe të ardhurat e siguruara nga ky i fundit nga punësimi pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., ndërkohë që ka kërkuar përjashtimin nga analiza financiare të investimit të shumës 4.000.000 lekë, deklaruar dhënë bashkëshortit të saj.

2.1.2.2 Bazuar në arsyetimin si më sipër për personin tjetër të lidhur, z. \*\*\*. \*\*\*, Komisioneri Publik vlerëson se, në të njëjtën logjikë, në analizën financiare të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*. \*\*\*, për verifikimin e burimeve të ligjshme të tij për huadhënien, në zërin *shpenzime*, duhet të përfshihet dhe investimi prej 4.000.000 lekë në këtë shoqëri.

2.1.3 Në përfundim, për këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë dhe të justifikojë burimet e ligjshme të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, dhuruesve, z. \*\*\*. \*\*\*. dhe z. \*\*\*. \*\*\*, për shumat e deklaruara të dhuruara, të cilat kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë të pasurisë, “*apartment banimi*”, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016.

2.2 Lidhur me burimin tjetër të deklaruar për blerjen e kësaj pasurie, *kredi e butë në shumën 2.240.000 lekë, mbi ligjshmërinë e përfitimit të saj nga subjekti në statusin si e pastrehë, shitjen e kësaj pasurie dhe çmimit të blerjes, në dukje preferencial*, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi pretendimet e saj edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj. Ky shkak do të trajtohet më gjerësisht në vijim në analizimin e kriterit profesional, pasi subjekti i rivlerësimit, përveçse ka përfituar jashtë kriterëve ligjore kredinë lehtësuese, duke rënë ndesh kështu me përmbushjen e standardeve të etikës profesionale, në të njëjtën kohë, ka hetuar në kushtet e konfliktit të interesit katër (4) procedime penale me Bashkinë Fier, të cilat do të detajohen në vijim.

**3. Lidhur me shkakun ankimor mbi mosdeklarimin e aksioneve të bashkëshortit në masën 40%, në shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., Komisioneri Publik, sikundër ka trajtuar gjerësisht dhe në ankim dhe parashtrimet e seancës së datës 16.1.2024, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këto aksione, duke mos deklaruar posedimin e tyre.**

3.1 Edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi pretendimet e saj mbi arsyet e mosdeklarimit të këtyre kuotave në Deklaratën “Vetting”.

3.2 Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se prej kësaj shoqërie janë përfituar të ardhura në formë page, deri në vitin 2010, prej personave të tjerë të lidhur me subjektin (z. \*\*\*. \*\*\*. dhe bashkëjetuesja e tij, znj. \*\*\*. \*\*\*.), deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si një nga burimet e të ardhurave të këtyre personave për të krijuar shumat e dhuruara subjektit<sup>5</sup>. Pretendimi i

<sup>4</sup> Gjatë hetimit është administruar, ndër të tjera, edhe deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*/2.2016, e z. \*\*\*. \*\*\*, në të cilën deklarohet se: “... një pjesë të të ardhurave, sikundër cituar në deklaratë me burim emigracioni nga vitet 1992-1998, dhe nga punësimi informal transport udhëtarësh, ia ka dhënë djalit \*\*\*. \*\*\*, për çeljen e aktivitetit të tij tregtar me shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., në formën e investimit fillestar”. Depozituar nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së.

<sup>5</sup> Trajtuar gjerësisht më sipër në analizimin e burimeve të pasurisë *apartment*.

subjektit të rivlerësimit, se përgjegjësia për çregjistrimin e aktivitetit të shoqërisë është e organeve tatimore, nuk gjendet i mbështetur në legjislacionin në fuqi.

3.3 Në përfundim të procesit, i paprovuar mbeti dhe burimi i ligjshëm i krijimit të të ardhurave të investuara në këtë shoqëri<sup>6</sup>.

3.4 Në përfundim, për këtë shkak ankimi, *Komisioneri Publik* vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës, duke u ndodhur në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

4. *Lidhur me shkakun ankimor mbi pasurinë e llojit autoveturë “Audi” dhe deklaramit të pasaktë mbi të ardhurat nga paga e personit të lidhur, që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë autoveturë, Komisioneri Publik* vlerëson se subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, nuk paraqiti akte apo prova të reja për të mbështetur pretendimet e saj, mbi mospërputhjet e pagës së personit të lidhur midis vërtetimit të lëshuar nga ISSH<sup>7</sup>, në shumat 10.000-14.000 lekë, dhe deklaramit nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 70.000 lekë, duke e bërë deklaramin e subjektit të pasaktë, lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë autoveturë “Audi”. Pretendimet e subjektit, lidhur me përfitimin e diferencës së pagës në *cash*, mbetën të pambështetura.

4.1 Në përfundim, për këtë shkak ankimi, *Komisioneri Publik* vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

## **II.B - Për vlerësimin e kontrollit të figurës**

5. Komisioni, nga hetimi administrativ për vlerësimin e kontrollit të figurës, bazuar në përcaktimet e nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe Kreut V të ligjit nr. 84/2016, ka konkluduar se: [...] *nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës. Deklaramet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, duke u gjendur në kushtet me përcaktuara nga germa “b” e pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...] <sup>8</sup>.*

6. Komisioni, në cilësinë e organit që ka autoritetin kushtetues për të ushtruar kontroll të plotë mbi procesin e verifikimit të figurës, si dhe për të pasur akses në të gjitha materialet përkatëse, ka hetuar dhe ka vlerësuar rrethanat dhe faktet, të ndërlidhura këto edhe me të dhënat e dala nga kontrolli i pasurisë, si dhe ka administruar dy *Gjetje* të ONM-së (respektivisht nr. \*\*\* prot., datë \*\*.7.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2022).

<sup>6</sup> Për të cilat subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se të ardhurat e vjehrrit nga emigracioni janë të ardhura nga punësimi informal dhe, si të tilla, ato nuk konsiderohen si burime të ligjshme në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Edhe vetë Komisioni, në analizën financiare të kryer të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*. \*\*\*, arsyeton se: “... nuk i ka përfshirë të ardhurat nga emigracioni në mesin e burimeve të ligjshme, për sa kohë që nuk provohet as shuma e të ardhurave të realizuara dhe as ligjshmëria e tyre në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës”.

<sup>7</sup> Referohuni vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë \*\*.1.2017, të ISSH-së, depozituar nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së.

<sup>8</sup> Referohuni f. 69 të vendimit të Komisionit.

7. Komisioni, në referencë të përcaktimeve të nenit B, pika 3, germa “b”, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, i ka çmuar *Gjetjet*,<sup>9</sup> së bashku me shtojcat e tyre, në cilësinë e provës, që dëshmojnë një fakt dhe rrethanë të vlefshme për qëllim të procesit të rivlerësimit, duke u njohur me të dhënat, paraqitur në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

7.1 *Mosdeklarimi i kontaktit të papërshtatshëm në formularin e DSIK-së, të shtetasit z. \*\*\*. \*\*\*., alias \*\*\*. \*\*\*.*

7.1.1 Nga aktet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit për çështje eventuale të lidhura me konfliktin e interesit, sipas informacionit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Fier<sup>10</sup>, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, mbasi është caktuar për të ndjekur procedimin penal nr. \*\*\*/2012, për veprën penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale*”, ka paraqitur dorëheqjen nga ky procedim, pasi ka qenë në dijeni të faktit se: ... *Nga ana e saj dhe e bashkëshortit është lidhur kontrata noteriale fillestare për blerjen e një apartamenti me sip. ndërtimore 95 m<sup>2</sup>,... Fier, me shtetasit \*\*\*. \*\*\*., kunat i shtetasit \*\*\*. \*\*\*. (\*\*\*. \*\*\*.), ndërsa kontrata përfundimtare e blerjes së apartamentit në vitin 2012 është lidhur me shtetasin \*\*\*. \*\*\*. (\*\*\*. \*\*\*.)*<sup>11</sup>. Pavarësisht ekzistencës së faktit penal, për shkak të kësaj marrëdhënie kontraktuale, subjekti ka çmuar se çdo lloj vendimmarrje e saj, për arsytet e cituara, do të dukej si e njëanshme. Kjo kërkesë e subjektit ka bindur dhe Drejtuesin e Prokurorisë Fier, që ka pranuar dorëheqjen e subjektit, në datën \*\*.4.2015.

7.2 *Kontakte të papërshtatshme faktike.* Nga aktet e administruara në dosje ka rezultuar se: (i) shtetasit \*\*\*. \*\*\*. dhe \*\*\*. \*\*\*. janë persona të tjerë të lidhur me subjektin, sipas nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, pasi i kanë dhuruar shumën 1.000.000 lekë, për blerjen e apartamentit në Fier, në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit të saj; (ii) shtetasit \*\*\*. \*\*\*., \*\*\*. \*\*\*. dhe bashkëshorti i subjektit, z. \*\*\*. \*\*\*., kanë bashkëthemeluar dhe bashkadministruar disa shoqëri gjatë viteve 2003 – 2012 (si: “\*\*\*\*” sh.a., “\*\*\*\* \*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*\*” sh.p.k. (iii) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti<sup>12</sup>, kanë lidhje të hershme familjare dhe biznesi, direkte ose të tërthorta, me anë të familjarëve ose krushqisë (të afërm të subjektit: \*\*\*. \*\*\*., \*\*\*. \*\*\*. dhe \*\*\*. \*\*\*.<sup>13</sup>), me shtetasit \*\*\*. \*\*\*., \*\*\*. \*\*\*. dhe \*\*\*. \*\*\*., së paku që prej vitit 2004, vitit 2007, vitit 2010 dhe më pas. Shtetasit \*\*\*. \*\*\*., \*\*\*. \*\*\*. dhe \*\*\*. \*\*\*., si dhe shoqëritë në zotërim të tyre, po hetohen prej SPAK-ut prej korrikut 2020 (procedimi penal nr. \*\*\*/2020) e më tej, në nëntor 2020 (procedimi penal nr. \*\*\*/2020), në kuadër të së ashtuquajturës “*afëra e inceneratorëve*”<sup>14</sup>. Referuar medias së shkruar është publikuar se, në shtator 2023, shtetasi \*\*\*. \*\*\*., me vendim të GJKKO, është shpallur fajtor dhe dënuar përfundimisht me 8 vjet burg<sup>15</sup> dhe, në tetor 2023, po nga kjo gjykatë, janë dënuar shtetasit

<sup>9</sup> Për më tepër referohuni përmbajtjes së dy *Gjetjeve*, si dhe anekseve përkatëse, bashkëlidhur tyre, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>10</sup> Për më tepër referohuni shkresës nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Fier.

<sup>11</sup> Referuar përmbajtjes së kontratës së datës \*\*.4.2012, shtetasi \*\*\*. \*\*\*., ka vepruar si përfaqësues me prokurë në emër të palës shitëse.

<sup>12</sup> Referuar dokumenteve bashkëlidhur *Gjetjeve* të ONM-së, rezultojnë se bashkëshorti i subjektit, për një periudhë kohe, së paku prej vitit 2018, ka qenë i punësuar me rol drejtues/pagë të konsiderueshme pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me aksionar themelues shtetasin \*\*\*. \*\*\*.

<sup>13</sup> Referuar përmbajtjes së formularit të DSIK-së, anëtarët e familjes në kontakt të mundshëm, të papërshtatshëm me anëtarë të kriminit të organizuar, përfshijnë krushqinë deri në nivel të dytë (vjehtëri dhe kunati/kunata).

<sup>14</sup> Për më tepër referohuni informacionit të përcjellë nga SPAK-u, drejtuar Komisionit dhe ONM-së, me shkresat nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.6.2022; nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.6.2022 dhe shkresa me nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.11.2022, si dhe *Gjetjeve* të ONM-së, së bashku me shtojcat përkatëse bashkëlidhur.

<sup>15</sup> Për gjykimin e inceneratorit të Fierit.

\*\*\*. \*\*\*. dhe \*\*\*. \*\*\*., me 6 vite e 8 muaj burgim secili, si dhe shtetasja \*\*\*. \*\*\*., dënuar me 4 vite e 8 muaj burg<sup>16</sup>.

7.3 *Përdorimi i automjeteve.* Përveç identifikimit të kontakteve dhe konstatimit të ndërthurjeve të vazhdueshme të interesave privatë e familjarë të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me këta persona të proceduar penalisht, nga aktet e administruara, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti, kanë pasur në përdorim automjetet në pronësi të shtetasve \*\*\*. \*\*\*., \*\*\*. \*\*\*., apo shoqërive të krijuara prej tyre, gjatë viteve 2019 – 2020, përkatësisht automjetin me targë \*\*\* dhe automjetin me targë \*\*\*, i cili ka qenë në përdorim nga kompania “ \*\*\*” sh.p.k.<sup>17</sup> Gjithashtu, z. \*\*\*. \*\*\*., personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, ka qenë i punësuar që prej vitit 2018 deri në maj të vitit 2022 në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., në një pozicion të rëndësishëm, dhe kjo e fundit kishte lidhje të ngushtë dhe aktive me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe me shtetasin \*\*\*. \*\*\*. (partner aktiv, përfaqësues i..., shoqëri zbatuese/nënkontraktore...). Për këtë shoqëri, media e shkruar ka publikuar se, në gusht 2023, GJKKO, në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\*/2020, ka vendosur sekuestro preventive për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>18</sup>, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

7.4 Komisioni, lidhur me kontaktet më sipër, pasi i ka gjetur të drejta të gjitha shpjegimet e subjektit, i ka bërë pjesë të arsyetimit të tij si në vijim: [...] *Subjekti i rivlerësimit, për shkak të marrëdhënieve familjare, ka lidhje me shtetasin \*\*\*. \*\*\*. (kunati i subjektit), dhe bashkëjetuesen e tij \*\*\*. \*\*\*. Në asnjë rast apo rrethanë nuk u konstatua që subjekti apo bashkëshorti i saj kanë pasur kontakte me këto persona pas regjistrimit të procedimit penal ndaj tyre. Gjithashtu, në asnjë rast të vetëm, nuk u konstatuan kontakte të papërshtatshme të subjektit apo bashkëshortit të saj me personat \*\*\*. \*\*\*., \*\*\*. \*\*\*. dhe \*\*\*. \*\*\*. [...]*<sup>19</sup>.

7.5 **Komisioneri Publik**, sikundër trajtuar gjerësisht dhe në ankim dhe parashtrimet e datës 16.1.2024, vlerëson se interpretimi i Komisionit, si më sipër, nuk vjen në harmoni me vetë qëllimin e procesit të rivlerësimit, shprehur në nenin 179/b të Kushtetutës dhe nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, duke mbajtur në konsideratë rëndësinë që ka ky proces në rikthimin e besimit të publikut, i cili gjen vend në vetë qëllimin dhe frymën e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kontrollin e figurës. Procesi i rivlerësimit synon që të identifikojë ato subjekte rivlerësimi, të cilët, nga faktet dhe rrethanat e dala, rezultojnë se janë të papërshtatshëm për vijimin e detyrës. Në këtë vështrim, Komisioni nuk ka arsyetuar dhe vlerësuar nëse rrethanat e dala, paraqitur si *Gjetje* nga vëzhguesi ndërkombëtar, përbëjnë bazë të mjaftueshme brenda përcaktimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

7.5.1 Në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i rastit objekt ankimi, në vëmendje edhe të përmbajtjes së aktit - Rekomandim dhe *Gjetjeve* të ONM-së, rezulton se, edhe pas shpjegimeve të dhëna në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me mosdeklarimin e kontaktit të papërshtatshëm të saj/personit të lidhur me të, bashkëshortit, me shtetasin \*\*\*. \*\*\*. (\*\*\*. \*\*\*.), në prill të vitit

<sup>16</sup> Për gjykimin e inceneratorit të Elbasanit.

<sup>17</sup> Ku ka qenë i punësuar bashkëshorti i subjektit, z. \*\*\*. \*\*\*.

<sup>18</sup> Në kuadër të gjykimin të inceneratorit të Tiranës.

<sup>19</sup> Për më tepër referohuni në pikën 1.6, f. 43, të vendimit të Komisionit.

2012, sikurse e kërkon ligji nr. 84/2016, referuar Shtojcës nr. 3 – “*Deklarata për Kontrollin e Figurës*”.

7.5.2 Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit nuk gjenden të bazuara në provat e administruara dhe rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka plotësuar me mangësi Shtojcën nr. 3, “*Deklarata për kontrollin e figurës*”, pasi nuk ka deklaruar kontaktin me një person të përfshirë në krimin e organizuar si dhe shkëmbimin/shitblerjen e pasurisë ndërmjet tyre (Shtojca 3 e ligjit nr. 84/2016, pjesa 5, germet “d<sup>20</sup>” dhe “e<sup>21</sup>”).

7.5.3 Për sa më sipër, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>22</sup>, i cili ka mbajtur qëndrimin se: [...] *kontrolli për figurën bazohet në dy komponentë komplementarë të njëri-tjetrit, në elementin përmbajtësor të këtij kontrolli, i cili është konstatimi i ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm, si dhe në elementin formal, që është konstatimi i plotësisë dhe i besueshmërisë së deklaramit* [...], vlerësohet se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur me të kanë pasur një kontakt të papërshtatshëm, për të cilin, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor ta deklaronte sipas Shtojcës nr. 3, të ligjit nr. 84/2016. Mosdeklarimi i këtij kontakti përbën një të metë, i cili, në këndvështrim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84 /2016, dhe të nenit DH, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, do të duhet të konsiderohet si deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës.

7.5.4 Në referencë të legjislacionit të sipërcituar, Komisioneri Publik çmon se vlerësimi i Komisionit në këtë rast ka qenë i mangët, në raport me faktet e rrethanat e çështjes dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nën dritën e përcaktimeve të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016.

7.5.5 Komisioneri Publik, edhe pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti në Kolegji, vlerëson se përfundimi i Komisionit lidhur me ***kontaktet e papërshtatshme faktike*** (shtetasit \*\*\*, \*\*\*, \*\*, \*\*, \*\*, dhe \*\*, \*\*\*) ***punësimi i personave të lidhur të subjektit në kompani, të krijuara nga këta shtetas, përdorimi i automjeteve, udhëtimet*** etj., është rrjedhojë e një vlerësimi të mangët, të pabazuar në prova dhe interpretimi jo të drejtë të ligjit të posaçëm. Thënë kjo referuar edhe jurisprudencës se Kolegjit (vendimit (JR) nr. 5/2019, 30/2019 etj.), ku lidhur me mjaftueshmërinë dhe vërtetësinë e deklaramit, për sa i përket aspektit përmbajtësor të kontrollit të figurës, afati i tij mund të shtrihet edhe përpara datës 1 janar 2012, pra edhe përpara periudhës nga data 1 janar 2012, përcaktuar sipas pikës 2, të nenit DH, të aneksit të Kushtetutës.

7.5.6 Nisur nga kjo praktikë, për qëllim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit 179/b, të aneksit të Kushtetutës, do të përbënte një vlerësim logjik, objektiv dhe proporcional, nëse kontrolli për kontakte të papërshtatshme, kur ato provohen me prova të besueshme dhe të mjaftueshme, do të shtrihet edhe pas datës së deklaramit/plotësimit të Shtojcës nr. 3 të ligjit nr. 84/2016<sup>23</sup>.

<sup>20</sup> Referuar Shtojcës nr. 3, pjesa 5, “Të dhëna për sigurinë”, në germën “d”, shtrohet pyetja: “A jeni në dijeni që një nga anëtarët e familjes (me termin “anëtar familjeje”, do të kuptohet bashkëshortja/bashkëshorti i tij, i afërti deri në shkallë të katërt ose krushqi deri në shkallë të dytë...) suaj ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar”?

<sup>21</sup> Referuar Shtojcës nr. 3, pjesa 5, “Të dhëna për sigurinë”, në germën “e”, shtrohet pyetja: “A keni pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar”?

<sup>22</sup> Për më tepër referohuni në vendimin (JR) nr. 30/2019.

<sup>23</sup> Në këtë vështrim, duket se ka qenë edhe vlerësimi i Kolegjit në vendimin (JR) nr. 7/2020, ku, ndër të tjera, ka mbajtur qëndrimin se: [63.] ... Vetë përcaktimi i këtij afati me pikënisje datën 1 janar 2012 dhe pikë fundore datën e deklaramit sipas ligjit, konfirmon më së miri se, në lidhje me këtë periudhë kohore, do të vlerësohet saktësia dhe vërtetësia e deklaramive të

7.5.7 Shpjegimet e subjektit, edhe gjatë seancës së datës 16.1.2024, në vlerësimin e Komisionerit Publik, mbetën të pambështetura në aktet e administruara në dosje, pasi rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti, kanë pasur kontakte të vazhdueshme në formën e takimit, udhëtimit etj. me personat e sipërcituar. Si subjekti, ashtu edhe personi i lidhur me të, bashkëshorti kanë pasur marrëdhënie jo vetëm sociale e familjare, por edhe biznesi (gjatë viteve 2002 - 2022) dhe punësimi me z. \*\*\*. \*\*\*, \*\*\*. \*\*\*, \*\*\*. \*\*\*, dhe \*\*\*. \*\*\*. Të gjithë këta të fundit janë proceduar penalisht<sup>24</sup> nga SPAK për akuza të krimit të organizuar, në kuadër të të ashtuquajturës “*afëra e inceneratorëve*” për vepra penale të parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe, për rrjedhojë, për efekt të ligjit nr. 84/2016, do të duhet të konsiderohen kontakte të papërshtatshme.

7.5.8 Komisioni duket se është bazuar vetëm në momentin procedural të regjistrimit të hetimit penal nga ana e SPAK-ut, si dhe regjistrimit të emrave të personave fizikë dhe ata juridikë, në kuadër të këtyre hetimeve, duke arritur, ndër të tjera, në përfundimin se, *në asnjë rast apo rrethanë, nuk u konstatua që subjekti apo bashkëshorti i saj kanë pasur kontakte me këta persona pas regjistrimit të procedimit penal ndaj tyre.*

7.5.9 Komisioneri Publik vlerëson se ngjarjet e vitit 2018, kur çështja u bë publike dhe zhvillimet e mëtejshme gjatë vitit 2020, kur çështja iu referua për hetim në SPAK, në vazhdim me shpalljen fajtor dhe dënimin nga GJKKO të shtetasve \*\*\*. \*\*\*, \*\*\*. \*\*\*, dhe \*\*\*. \*\*\*, në lidhje me inceneratorët, si dhe vendosja e sekuestros preventive mbi pasuritë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., janë relevante për t’u vlerësuar në ndikimin që kanë në besimin e publikut për qëllim të procesit të rivlerësimit. Sa i përket punësimit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe përdorimit të automjeteve, sikundër trajtuar gjerësisht në ankim, vlerësojmë se pretendimet e subjektit, edhe para Kolegjit, nuk janë bindëse dhe nuk provuan të kundërtën e barrës së provës.

**8.** Në përfundim, Komisioneri Publik vlerëson se, për kontrollin e kriterit të figurës, gjenden fakte, të cilat e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Ky vlerësim negativ qëndron edhe nga një vlerësim tërësor i çështjes, pasi gjenden një sërë rrethanash të vlefshme, për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

### **III.C - Për vlerësimin e aftësive profesionale**

**9.** Komisioni, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, si dhe shqyrtimit të denoncimeve, bazuar në përcaktimet e nenit E të aneksit të Kushtetutës, dhe të ligjit nr. 84/2016, ka konkluduar se: [...] *subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues, në kuptim të gërmës “c”, pika 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...].*<sup>25</sup>

---

*subjektit të rivlerësimit, një ndër elementet e përcaktuara në objektin e kontrollit të figurës, sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016, dhe jo ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme [...].*

<sup>24</sup> Për më tepër referohuni në Gjetjet nr. \*\*\* prot., datë \*\*7.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë \*\*10.2022, dhe anekset përkatëse, si dhe Rekomandimit për paraqitje ankimi, datë 16.2.2023.

<sup>25</sup> Referohuni f. 69 të vendimit të Komisionit.



10. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ndër të tjera, ka administruar dhe *Gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, të cilat ngrenë çështje për vlerësim e etikës, konfliktit të interesit dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, trajtuar në vijim.*

11. *Lidhur me ligjshmërinë për përfitimin e kredisë së butë, nga ana e subjektit të rivlerësimit, për blerjen e apartamentit me sip. 83,88 m<sup>2</sup> në Fier, shitjen e këtij apartamenti dhe çmimit në dukje preferencial, si dhe ligjshmërisë së shitjes së tij*

11.1 Sikundër trajtuar gjerësisht dhe në ankim, subjekti i rivlerësimit, në Deklaratën *Vetting* 2017, ka deklaruar si burim për pagesën e kështit të dytë të apartamentit në Fier me sip. 83,88 m<sup>2</sup>, kredinë në shumën 2.240.000 lekë, përfituar me statusin e të pastrehut, me vendim të Këshillit Bashkiak Fier<sup>26</sup>, sipas ligjit nr. 9232/2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

11.2 Komisioneri Publik vlerëson se ky shkak ankimi, në kuadër të vlerësimit për etikën/integritetin e magjistratit, trajtuar edhe në kontrollin e kriterit të pasurisë, përbën bazë edhe për një vlerësim tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

11.3 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” (i ndryshuar), përfitojnë kredi të buta vetëm ato familje, që kanë të ardhura të pamjaftueshme dhe një ndër këto kategori janë familjet që kanë të ardhura brenda kufijve të përcaktuar në nenin 19<sup>27</sup> të këtij ligji.

11.4 Nga praktika e aprovimit të kredisë lehtësuese të vitit 2011 konstatohet se, në krahasim me përfituesit e tjerë, të ardhurat familjare për frymë të subjektit, rezultojnë më të larta (afërsisht 170.000 – 190.000 lekë/muaj) se baza, mbi të cilat ka vendosur Këshilli Bashkiak për raste të ngjashme (150.000 lekë). Për më tepër, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë banesë të përfituar nga programet sociale, megjithëse vijon të paguajë kredinë e butë<sup>28</sup>, veprim juridik ky, i cili duket se bie ndesh me nenin 20/1<sup>29</sup> të ligjit “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar.

11.5 Nga hetimi ka rezultuar, gjithashtu, se subjekti i rivlerësimit ka hetuar disa çështje penale që lidhen me Bashkinë Fier, ndërkohë që kishte përfituar nga ana e Bashkisë Fier një kredi me kushte lehtësuese, në gusht të vitit 2011, për një periudhë 20-vjeçare, me statusin e të pastrehut.

11.6 Lidhur me katër çështje të hetuara me Bashkinë Fier, rezultoi se subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës si prokurorë, duke hetuar procedimet penale (trajtuar më gjerësisht në ankim), ndërkohë që duhet të kishte dhënë dorëheqjen, konkretisht: (i) subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*/2013, iniciuar nga kallëzimi i Sektorit kundër Krimit Financiar Fier, mbi veprime të paligjshme nga

<sup>26</sup>Vendim nr. \*\*\*, datë \*\*.7.2010, i Këshillit Bashkiak Fier, për ndryshimin e një vendimi të mëparshëm nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2009, duke: (i) zëvendësuar listën e përfituesve me një tjetër; dhe (ii) shtuar një listë tjetër familjesh në pritje të marrjes së një kredie të butë, duke përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit.

<sup>27</sup> [2]. Kur banesa me kosto të ulët sigurohet përmes blerjes nga tregu, nëpërmjet një kredie hipotekore nga bankat e nivelit të dytë, me interesa të lehtësuara nga shteti, niveli maksimal i të ardhurave llogaritet nga ministria që mbulon fushën e strehimit, bazuar në vlerat mesatare të shitblerjes së banesave në treg për çdo qytet, normat e strehimit, kushtet e kreditimit nga bankat e nivelit të dytë dhe treguesin e aftësisë paguese, jo më shumë se 30 për qind [...].

<sup>28</sup> Për më tepër referohuni në DV-2017, në të cilën subjekti deklaroi shlyerjen e kredisë në shumën 143.730,60 lekë dhe ka për të shlyer shumën 1.670.487,22 lekë.

<sup>29</sup> [...] “Kufizimet” 1. Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët, nuk mund t’i kalojë të drejtat që ajo ka mbi këtë banesë të një person tjetër, apo ta lëshojë atë me qira gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë [...].

zyrtarë publikë të Bashkisë Fier, në kuadër të projektit për ndërtimin e Pallatit të Sportit, gjatë viteve 2011 - 2012; **(ii)** subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*/2014, për akuzat “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim të dokumenteve”, lidhur me lejen e ndërtimit lëshuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Fier, në favor të një kompanie ndërtimi; **(iii)** subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*/2015, për akuzat “shpërdorim detyre”, nga ana e IMT-së Bashkia Fier, për prishje të pronës private; **(iv)** subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendim për mosfillim të procedimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2012, ndaj kryetarit të Bashkisë Fier, për “shpërdorim detyre” dhe “shkatërrim prone”.

11.7 Bazuar në sa më sipër trajtuar, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe pas shpjegimeve të saj, gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën se ajo, subjekti, ka qenë përfituese e kredisë lehtësuese jashtë kriterëve ligjore, në të njëjtën kohë që ushtronte detyrën e prokurorit në qytetin e Fierit. Duket se ky përfitim është rrjedhojë e funksionit që ushtronte subjekti i rivlerësimit, duke rënë ndesh kështu me përmbushjen e standardeve të etikës profesionale. Kjo situatë e konstatuar, së bashku me çmimin në dukje preferencial, si dhe shitjen e kësaj pasurie, në kundërshtim me përcaktimet ligjore, parë në raport dhe me procedimet penale që subjekti i rivlerësimit ka ndjekur pas vitit 2011 ndaj Bashkisë Fier, në një vlerësimin tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, çon në aplikimin e nenit 61, pika 5 e këtij ligji, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

**12.** *Lidhur me dy çështjet me shoqërinë “\*\*\*\*” sh. a.,* sikundër trajtuar gjerësisht në ankim, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurores së çështjes, ka hetuar në kushtet e konfliktit të interesit<sup>30</sup> procedimet penale nr. \*\*\*/2015 dhe nr. \*\*\*/2015, ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., ndërkohë që bashkëshorti i subjektit ka qenë i punësuar në këtë shoqëri për periudhën tetor 2013 – 2019. Shpjegimet e subjektit, edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, në vlerësimin e Komisionerit Publik, për sa trajtuar dhe gjerësisht në ankim, nuk vlerësohen bindëse.

**13.** *Lidhur me mosfillimin e procedimit nr. \*\*\*/2020* ndaj gjyqtarit \*\*\*. \*\*\*, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti në Kolegj, rezultoi se subjekti nuk ka kryer verifikime dhe hetime lidhur me këtë kallëzim dhe mungesën e arsytimit të duhur për mosfillimin e procedimit. Arsyetimi i subjektit se, mungesa e një kallëzimi nga ana e Komisionit nuk e mundëson fillimin e hetimeve për këtë çështje, nuk gjen mbështetje në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Neni 283 i Kodit Penal, “Kallëzimi nga ana e shtetasve”, parashikon se *çdo person që ka marrë djeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë*, duke çuar kështu në një mungesë të pajustificuar dhe të paligjshme të vendimit të mosfillimit të hetimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke u gjendur në kushtet e pikave 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**14.** Në përfundim për kriterin e aftësive profesionale, në vlerësimin e Komisionerit Publik procedimet e marra në shqyrtim, si më lart trajtuar, për të cilat në të gjitha rastet subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillim apo pushim të procedimit penal, përmbajnë të meta të dukshme dhe mungesë arsytimi, mangësi këto që duhen vlerësuar në raport me përmbushjen

---

<sup>30</sup> Bazuar në pikën 4, të nenit 75, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

e standardeve të përcaktuara nga neni 73, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, për sa i përket aftësisë për të hetuar, për të marrë urdhra dhe vendime. Në të gjitha rastet e trajtuara më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, fakt i cili, së bashku me mangësitë e vërejtura, janë të mjaftueshme për vlerësimin në tërësi të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me nenin 61, pika 5, të këtij ligji.

#### **IV. Kërkimi përfundimtar i ankimit**

**15.** Komisioneri Publik, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 606, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Mariola Mërtiri.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**